VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 6 (1013), datë 21.3.2022, vendosi pranimin e kërkesës për marrjen e masës së përkohshme dhe urgjente dhe me efekt të menjëhershëm ekzekutues të kërkueses Shqiponja Likaj; caktimin si kujdestare të përkohshme ligjore për shtetasen madhore Elvira Marinaj, e datëlindjes 15.9.1991, motrën e saj shtetasen Shqiponja Likaj, për të kryer të gjitha veprimet juridike të saj, në emër dhe për llogari të shtetases madhore Elvira Marinajn dhe për ta përfaqësuar atë, në çfarëdolloj institucioni publik a privat, derisa të shqyrtohet me vendim përfundimtar çështja gjyqësore, me objekt heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Elvira Marinaj dhe caktim kujdestari.